

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
 Viti XXIII, nr. 6969
 E martë, 15 gusht 2023
 Çmimi 0.40

Rama e nderon ish-ministrin Mehaj me "Çelësin e Qytetit"



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
 facebook.com
 Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBROJTJA KËRKON NGA SPECIALJA TË DEKLAROHET SE NUK KISHTE TRAFIKIM TË ORGANEVE NGA UÇK-ja



- Avokati i Hashim Thaçit kërkon llogari për njeriun e Kurtit që u tha se kërkoj dëshmitarë katolikë

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka kërkuar nga trupi gjyqësor të tregojë se akuzat ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit nuk kanë të bëjnë me trafikim organesh. Avokati i Thaçit, Gregory Keohe, të hënën kur ka nisur dëshminë dëshmitari i 16, ka thënë se kohën e fundit janë

publikuar disa artikuj rusë e që janë pasqyruar në mediet evropiane, se liderët e UÇK-së janë marrë me trafikim të organeve. Ai ka thënë se këto pretendime janë të rreme pasi hetimi për trafikim ka përfunduar. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nuk e di nëse rusët janë duke u përpjekur të ndikojnë në

trupin gjyqësor të Speciales. Po ashtu, Keohe ka kërkuar sqarime lidhur me deklaratën e një biznesmeni nga Gjermania, i cili ka thënë se njerëz të afërt me kryeministrin Albin Kurti e kanë lutur t'i gjejë disa dëshmitarë katolikë që të dëshmojnë kundër Thaçit

AKTUALE



POLITIKANI I EKSTREMIT TË DJATHTË, KANDIDAT I PËLQYER NË ZGJEDHJET PRESIDENCIALE NË ARGJENTINË F. 2

KURTI TAKON ZËVENDËSMINISTRIN E JASHTËM TË TURQISË, FLASIN PËR DIALOGUN ME SERBINË DHE ZHVILLIMET NË VERI F. 5

35 TË BURGOSUR PAJISEN ME CERTIFIKATA PËR AFTËSIM PROFESIONAL F. 6

EKONOMI



FALJA E TATIMIT NË PRONË SHPËTON QYTETARËT, DËMTON KOMUNAT F. 8

SHQIPËRI, PROJEKTE NË FUSHËN E TURIZMIT DHE HARMONIZIM I TIJ F. 8

SPORT



ARLIND VELIU, 'YLLI I JAVËS' SË PARË NË SUPERLIGË F. 10

NIS PUNIMET SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE



Reagim i KMDLNj-së
PËRGJEGJËSIA PARA LIGJIT E NJËJTË PËR TË GJITHË, JO PËRGJEGJËSI SELEKTIVE!



RENOVA
 PUTZ
 Maqedoni
 Xhepçisht -Tetovë
 Gurëz-Ferizaj
 Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
 +389 44 487 755
 Fax: +389 44 487 200
 Mbx: +377 44 501 289
 E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
 GROUP SH.P.K.
 NDËRTIM
 PROJEKTIM
 SHITJE
 INFO: 049-111-101,
 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
 FABRIKA E LLAQEVE
 MITROVICË
 044/256-051
 044/367-061
 028/532-617
 STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
 info@kolegji.biznesi.com
 030 500 878 | 045 500 878
 044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
 VIENNA INSURANCE GROUP
 SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
 DEGA KOSOVË
 Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
 Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
 E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
 Digital Agency
 Endrit Shaqiri
 +38344685122
 Internet Website,
 Marketing...

Polonia do të mbajë referendum për kufirin me gjemba me Bjellorusinë

VARSHAVË, 14 GUSHT - Polonia do t'ua mundësojë shtetasve të vendosin nëse duhet mbajtur murin me gjemba në kufi me Bjellorusinë, ka thënë ministri polak i Mbrojtjes, Mariusz Blaszczak.

Referendumi do të mbahet më 15 tetor, në ditën e njëjtë kur mbahen zgjedhjet parlamentare.

Votuesit polakë do të pyeten nëse e mbështetin "heqjen e barrierës në kufirin në mes të Polonisë dhe Bjellorusisë", ka thënë Blaszczak.

Ndonëse ndërtimi i murit me gjemba është kritikuar nga politikanët opozitarë - gjatë procesit të ndërtimit - tani, duke marrë parasysh situatën aktuale me Bjellorusinë si aleate të ngushtë të Rusisë, nuk ekzistojnë

shumë zëra kundërshtues.

Së fundi, Polonia është e shqetësuar për aktivitetet e mercenarëve të grupit rus Wagner në Bjellorusi, si dhe për numrin në rritje të migrantëve që duan të hyjnë në Bashkimin Evropian përmes territorit bjellorus.

Vitin e kaluar Polonia e ka siguruar kufirin prej 418 kilometrash me Bjellorusinë, me gjemba të larta prej 5.5 metrash. Javën e kaluar ministri Blaszczak ka thënë se Polonia është duke planifikuar të dërgojë rreth 10 000 ushtarë shtesë në kufi me Bjellorusinë, për ta mbështetur Gardën Kufitare. "Ne do ta afrojmë ushtrinë më afër kufirit me Bjellorusinë për ta dëbuar agresorin, ashtu që të mos guxojë të na sulmojë", ka thënë ai.



Mercenarët e Wagnerit kanë shkuar në Bjellorusi pasi i kanë dhënë fund rebelimit në Rusi në fund të muajit qershor. Ata e kanë

marrë këtë vendim në kuadër të një marrëveshjeje të arritur në mes të presidentit rus Vladimir Putin dhe shefit të Wagnerit,

Yevgeny Prigozhin, të ndërmjetësuar nga lideri bjellorus Alyaksandr Lukashenka.

Suedia bën thirrje për vigjilencë jashtë vendit pas djegieve të Kuranit



Stokholmi, 14 gusht - Një zyrtar i lartë suedez ka thënë të hënën se suedezët jashtë vendit dhe bizneset e lidhura me Suedinë "duhet ta rrisin vigjilencën dhe kujdesin" pas djegieve të fundit të Kuranit në vend dhe protestave në botën myslimane.

Henrik Landerholm, këshilltar i Sigurisë Kombëtare i Suedisë, tha se ka shenja të "kërcënimeve të larta" ndaj vendit dhe ndaj interesave suedeze jashtë vendit, duke shtuar se gjendja e sigurisë është përkeqësuar.

Në një komunikatë për medie, Landerholm tha se "përfaqësuesit e grupeve terroriste kanë bërë thirrje për sulme kundër Suedisë. Shtetet dhe aktorët e tjerë kanë ndihmuar në zmadhimin e mesazheve të tilla". Ai theksoi se Suedia tani është cak primar i sulmeve.

Landerholm shtoi se ka "shenja" se grupet po planifikojnë, po ashtu, sulme të tjera kundër interesave suedeze jashtë vendit, duke e nënvizuar sulmin në Ambasadën e Suedisë në Bagdad

muajin e kaluar dhe tentim-sulmin në misionin diplomatik në Bejrut javën e kaluar.

Qeveria suedeze dhe autoritetet relevante "janë duke i përcjell zhvillimet, dhe kanë marrë masa të ndryshme dhe po punojnë nga afër me partnerët ndërkombëtarë për t'i mbrojtur suedezët dhe interesat suedeze jashtë vendit, si dhe për t'i neutralizuar mesazhet e urrejtjes që po shpërndahen për Suedinë".

Këtë muaj Suedia i rriti kontrollin në pikat kufitare.

Politikani i ekstremit të djathtë, kandidat i pëlqyer në zgjedhjet presidenciale në Argjentinë

BUENOS AIRES, 14 GUSHT - Përfaqësuesi i lëvizjes së djathtë ekstreme, Javier Milei, tronditi kastën politike argjentinase. Ai doli si politikani më i votuar në garën paraprake për t'u kualifikuar si kandidat për president në zgjedhjet e përgjithshme të muajit tetor.

Milei, që njihet si adhurues i ish-presidentit Trump, kërkon eliminimin e Bankës Qendrore të Argjentinës, i konsideron ndryshimet klimatike si një teori të pavërtetë, thotë se edukata seksuale në shkollë është një komplot për ta shkatërruar familjen, beson në legalizimin e shitjes së organeve dhe dëshiron ta bëjë më të lehtë blerjen dhe zotërimin e armëve.

Në fjalimin nga selia e tij, Milei u betua t'i "japë fund kastës parazite, të korruptuar dhe të padobishme

që ekziston në këtë shtet", siç u shpreh ai. "Sot ndërmorëm hapin e parë drejt rindërtimit të Argjentinës. Një Argjentinë ndryshe është e pamundur me të njëjtët njerëz", thotë ai dhe shton: "Këta janë njerëzit e vjetër, që kanë dështuar gjithmonë, të njëjtët njerëz të vjetër që kanë dështuar në 100 vjetët e fundit".

Me 92 për qind të votave të numëruara deri të dielën në mbrëmje, analistët janë të një mendimi, se kandidati që fitoi famë dhe u popullarizua duke kritikuar me pasion të ashtuquajturën "kastë politike", i tejkaloi pritshmëritë. Milei mori 30 për qind të votave, ndërkohë që kandidati kryesor i koalicionit opozitar, "Të Bashkuar për Ndryshim", fitoi 28 për qind dhe kandidati i koalicionit qeverisës, "Bashkimi për Atdheun", mori 27



%.

Rezultatet e para sugjerojnë që Argjentina është shteti i fundit në rajon ku votuesit po mbështesin kandidatë që nuk i takojnë klasës aktuale politike, si një mënyrë për

ta shprehur pakënaqësinë e tyre kundër politikanëve tradicionalë. Në Argjentinë pakënaqësia është e dukshme mes votuesve. Vendi po përballet me një inflacion vjetor mbi 100 për qind, shtim të

varfërisë dhe zhvlerësim të monedhës.

Milei fitoi përkrahje me idenë e tij që Argjentina ta zëvendësojë monedhën e saj peso me dollarin amerikan.

Reagim i KMDLNj-së

Përgjegjësia para ligjit e njëjtë për të gjithë, jo përgjegjësi selektive!

Kohët e fundit ka më shumë raste kur gazetarët po pengohen gjatë kryerjes së punëve të tyre sikur që është një vullnet më i madh për t'iu siguruar kushte më të mira dhe më të sigurta për punë. Përshkallëzimi i dhunës kundër gazetarëve ishte shprehur sidomos në komunat e Veriut të Kosovës në të cilat KFOR-i mori edhe përgjegjësi policore, por dështoi t'i merrte në mbrojtje gazetarët të cilët me të gjitha mjetet e mundshme u penguan. Pati disa arrestime në rastet kur u identifikuan penguesit dhe sulmuesit e gazetarëve, mirëpo pastaj thuajse të gjithë u liruan ende pa përfunduar procedurat. KMDLNj edhe më parë ka kërkuar që gazetarët të kenë një mjedis të sigurt për punën e tyre për përmbushjen e misionit për informim të drejtë dhe profesional për ngjarjet që paraqesin interes për publikun, gjithnjë duke iu përmbajtur kodeksit gazetaresk e që jo gjithherë veprojnë në

përputhje me këtë rregull të shkruar dhe të pashkruar. Rasti i fundit që ndodhi në Prizren, kur u pengua ekipi i gazetës "Nacionale", u monitorua nga KMDLNj sikur që edhe u dëgjua edhe incizimi midis gazetarit të "Nacionales" dhe personit që pastaj u arrestua. Nëse është përgjegjësi, e është përgjegjësi për të siguruar kushte dhe mjedis për punë të papenguar të medie, edhe mediet kanë përgjegjësi ta respektojnë palën tjetër që nuk e shpreh mendimin e njëjtë me këto media. Liria e shprehjes dhe liria e veprimt nuk janë privilegje vetëm për një palë dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë selektive sepse, nëse ndodh kështu, atëherë po e shkelim universalitetin e të drejtave të njeriut duke i zbatuar këto të drejta në mënyrë selektive. Pas ngjarjes në Prizren ishte një përshkallëzim i fjalorit edhe i atyre që duhet dhe i mbrojnë të drejtat e gazetarëve. Kishte deklarata se "duhet të

arrestohet ai kriminel" (penguesi i punës së gazetarit në fjalë), se ende nuk qenka arrestuar "ai kriminel", se duhet të arrestohen edhe policët që nuk i mbrojtën gazetarët etj. Për KMDLNj-në ky fjalor paragjykes dhe akuzues, ende pa filluar hetimet apo pa përfunduar gjykimi, nuk është asgjë tjetër përveç ndërhyrje flagrante në punën e organeve të ndjekjes dhe atyre gjyqësore. Edhe gjykata përkatëse në vendimin që e merr, qoftë edhe dënues, nuk e përdor cilësimin kriminel dhe kush i jep të drejtë një gazetari, aktivisti për të drejtat e njeriut apo të drejtat e gazetarëve që të përdorë këtë cilësim pas së cilës thuaja të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë bien nën ndikim të këtij shantazhimi publik dhe marrin vendime, që KMDLNj e vlerëson se janë në kundërshtim me nevojat aq më parë që mund të marrin ndonjë masë alternative që është në përputhje të plotë me natyrën dhe rrezikun e veprës. Në rastin

e Prizrenit është caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditëve për një të ndaluar sikur që ishte pezulluar për 72 orë një oficer policie për shkak të mosveprimit. Cili oficer policie ishte suspenduar në komunat e Veriut të Kosovës për shkak të mosveprimit ndonëse sulmet ndaj gazetarëve ishin shumë të ashpra dhe më të rrezikshme. Për KMDLNj-në ky është rast tipik i zbatimit të standardeve të dyfishta dhe rënie absolute nën ndikimin e presionit të publikut gjatë marrjes së vendimeve. KMDLNj edhe më herët ka reaguar kundër presionit publik në raste të shqiptimeve të rënda (sidomos me burg të përjetshëm) ndaj prokurorëve dhe gjykatave e që nuk ndodh në vendet ku mirëfilli sundon ligji. Te ne presioni dhe ndërhyrja në punën e gjyqësorit fillon kryesisht nga kreu më i lartë politik për të vazhduar pastaj edhe në nivele të tjera. KMDLNj ka reaguar në të gjitha rastet kur gazetarët janë

sulmuar apo penguar gjatë kryerjes së përgjegjësisë për informim të drejtë, objektiv dhe profesional duke kërkuar që edhe gazetarët t'u përmbahen mandatit të tyre. Në rastin e Prizrenit KMDLNj kërkon hetime për pengimin e punës së gazetarit ndonëse askush nuk po reagon në mbrojtje të të drejtave dhe lirive fetare që janë garantuar me ligj e që paraqet, pa asnjë dyshim, një qasje selektive në trajtimin e këtij rasti.

Të drejtat e njeriut janë të pandashme dhe të njëjta për të gjithë. Çdo përjashtim nga këto të drejta që iu takojnë me lindje është zbatim i standardeve të dyfishta e kjo pikërisht, sipas KMDLNj-së dhe nga aspekti i të drejtave të njeriut, është diskutueshëm. KMDLNj me kujdes do ta përcjellë këtë rast dhe do të reagojë ekskluzivisht në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, pa e paragjykuar rastin, duke besuar në zbatimin e ligjit për të gjithë, pa diskriminim.



Krasniqi e falënderon Turqinë për interesimin e vazhdueshëm për ta ndihmuar Kosovën

PRISHTINË, 14 GUSHT - Në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës, kryetari Memli Krasniqi ka pritur të hënën në takim zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Mehmet Kemal Bozay dhe delegacionin e tij. Krasniqi delegacionin turk e ka njoftuar për zhvillimet e fundit politike

në Kosovë, për qëndrimet e PDK-së në raport me to dhe rugën më të mirë përpara për vendin, drejt integritet euroatlantik e duke ruajtur raportet me aleatët nëpërmjet veprimeve të përgjegjshme politike. "Zëvendësministrin Bozay e falënderova për vizitën, interesimin dhe

gatishtësinë e vazhdueshme të shtetit tonë mik, Turqisë, për ta ndihmuar Kosovën në të gjitha etapat e shtetformimit. Thellimi i bashkëpunimit mes dy vende tona në fusha të ndryshme është në funksion të miqësisë mes vendeve tona dhe fuqizimit të shtetit tonë", ka thënë Krasniqi pas takimit.





Mbrojtja kërkon nga Specialja të deklarohet se nuk kishte trafikim organesh nga UÇK-ja

- Avokati i Hashim Thaçit kërkon llogari për njeriun e Kurtit që u tha se kërkoi dëshmitarë katolikë

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka kërkuar nga trupi gjyqësor të tregojë se akuzat ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit nuk kanë të bëjnë me trafikim organesh. Avokati i Thaçit, Gregory Keohe, të hënën kur ka nisur dëshminë dëshmitari i 16, ka thënë se kohën e fundit janë publikuar disa artikuj rusë e që janë pasqyruar në mediet evropiane, se liderët e UÇK-së janë marrë me trafikim të organeve. Ai ka thënë se këto pretendime janë të rreme pasi hetimi për trafikim ka përfunduar. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nuk e di nëse rusët janë duke u përpjekur të ndikojnë në trupin gjyqësor të Speciales. Po ashtu, Keohe ka kërkuar sqarime lidhur me deklaratën e një biznesmeni nga Gjermania, i cili ka thënë se njerëz të afërt me kryeministrin Albin Kurti e kanë lutur t'i gjejë disa dëshmitarë katolikë që të dëshmojnë kundër Thaçit

ndikim në dëshmitarë. Ka shumë artikuj të botuar në Prishtinë dhe që janë reflektuar në lajme dhe intervista në mënyrë të drejtpërdrejtë që një person shqiptar në Gjermani është takuar dhe kontaktuar nga Qeveria e Kosovës dhe thuhet se ky person në Gjermani është kërkuar të gjejë katër dëshmitarë katolikë kundër Thaçit. Ai citohet të ketë thënë që mua më është kërkuar të gjej dëshmitarë katolikë kundër Thaçit. E kuptoj që ZPS-ja ka përdorur ndërmjetës në Prishtinë për të gjetur dëshmitarë, megjithatë kjo është ndërhyrje në drejtësi për të gjetur dëshmitarë katolikë që të dëshmojnë kundër klientit tim. Dua ta ngre këtë dhe t'jua bëj me dije se kjo është ndërhyrje në drejtësi. Për të qenë i sinqertë nuk kam asnjë vend tjetër për të thënë këto përvetshë në trupin gjyqësor. Gjykata dhe unë si avokat kërkojmë disa shpjegime nëse janë kërkuar dëshmitarë nga dikush që është i pranishëm në

këtë sallë gjyqi. Do ta bëjmë edhe me shkrim", ka thënë Keohe. Këtë deklaratë të avokatit të Thaçit nuk ka dashur ta komentojë askush nga ZPS-ja, duke kërkuar që kjo të bëhet me parashtrim me shkrim. Mbrojtja e Thaçit kërkon nga trupi gjyqësor të tregojë se akuzat ndaj liderëve të UÇK-së nuk kanë të bëjnë me trafikim organesh. Më tutje, avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, ka kërkuar nga trupi gjyqësor që tregojë se akuzat ndaj liderëve të UÇK-së nuk kanë të bëjnë me trafikim organesh. Kjo kërkesë e avokatit Thaçi vjen në kohën kur janë botuar disa artikuj rusë e që janë pasqyruar në mediet evropiane se të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore janë marrë me trafikim të organeve. Sipas Keohe, kjo është false dhe se përderisa hetimi për trafikim ka përfunduar, dikush duhet ta thotë se aktakuza nuk ka të bëjë me trafikim të organeve. Ai ka thënë se nuk e di nëse rusët janë duke u përpjekur të ndikojnë në këtë

EPOKA ERE**Lirim GECI**

HAGË, 14 GUSHT - Pas disa javësh pushim në Gjykatën Speciale në Hagë, të hënën ka rinisur procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në këtë seancë janë zhvilluar debate të ashpra në mes të Zyrës së Prokurorit të

Specializuar (ZPS) dhe mbrojtjes së liderëve të UÇK-së.

Fillimisht avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, para trupit gjyqësor ka folur lidhur me akuzat e bëra nga një mërgimtar për katër dëshmitarë katolikë. Sipas intervistës, Ndue Gjinaj, një biznesmen nga Kosova që vepron në Gjermani, kishte thënë për "Nacionalen" se Ridvan

Muharremi, një njeri i kryeministrin Albin Kurti, pronar i restorantit "Bukë e Zemër", i ka kërkuar atij të gjejë dëshmitarë katolikë kundër Thaçit.

Avokati i Thaçit ka thënë se kjo temë është tejet shqetësuese. Sipas tij, nëse kjo ka ndodhur atëherë është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në drejtësi. "Tjetra që është shumë shqetësuese,

Kurti takon zëvendësministrin e Jashtëm të Turqisë, flasin për dialogun me Serbinë dhe zhvillimet në veri

PRISHTINË, 14 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me shefin e stafit, Luan Dalipi dhe zëvendësministrin e Drejtësisë, Blerim Sallahu, mirëpritën zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Mehmet Kemal Bozay, që po shoqërohej nga ambasadori i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angılı dhe këshilltari i presidentit Erdogan, Sabri Demiri.

Në takim u konfirmua përkushtimi për avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve tashmë shumë të mira ndërmjet dy shteteve.

Kryeministri Kurti shprehu falënderimin e tij për mbështetjen e vazhdueshme të Turqisë, në çdo fazë të shtetformimit, shtetndërtimit

dhe forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar, duke theksuar se mirëpritet bashkëpunimi me kabinetin e ri të presidentit të Turqisë, Rexhep Taip Erdogan. Fuqizimi i raporteve në fushën e ekonomisë, tregtisë dhe shëndetësisë, dhe planet e përpjekjet e dy palëve për të krijuar një forum ekonomik të përbashkët, ishin prej temave kryesore të diskutimit të këtij takimi.

Krahas tyre, kryeministri Kurti njoftoi delegacionin turk, të udhëhequr nga zëvendësministrin e Punëve të Jashtme, Bozay, edhe për procesin e dialogut me Serbinë të ndërmjetësuar nga Brukseli, dhe për zhvillimet e fundit në vend, përfshirë situatën në katër komunitat në veri.



trup gjyqësor, duke pretenduar se të akuzuarit janë përfshirë në këtë aktakuzë në trafikim të organeve, ndërsa ka theksuar se kjo nuk është e vërtetë. Pas kësaj seance ka vazhduar me dëgjimin e dëshmitarit të 16 me radhë në këtë çështje, me kodin "03879". Dëshmia e këtij dëshmitari pritet të zgjasë 4 deri në 5 ditë.

Trupi gjyqësor refuzon si provë një video që ZPS-ja pretendonte se ishte ceremonia e betimit të UÇK-së

Në seancën e së hënës ZPS-ja ka paraqitur një video ku shiheshin ish-komandanti i UÇK-së, Fatmir Limaj dhe Ismet Jashari, i njohur me nofkën komandant

"Kumanova".

ZPS-ja përmes kësaj videoje synonte të bënte një krahasim të një ceremonie të betimit që kishte përmendur dëshmitari i 16 në seancë private. "Të nderuar gjykatës, duke pasur parasysh identifikimin që bëri dëshmitari dhe duke pasur parasysh që është pranuar në mënyrë të përkohshme si provë materiale, ne mendojmë që është e përshtatshme të pranohet", ka thënë prokurori i ZPS-së.

Këtë video e ka kundërshtuar avokati i ish-presidentit Thaçi, Gregory Kehoe, duke thënë se mungon pjesa e betimit. "Doni të pranoni regjistrim për një betim që s'ka betim konkretisht? Prokuroria thotë që një dëshmitar tjetër ta identifikojë këtë. Në rregull, kur të vijë dëshmitari tjetër le ta bëjë. Fatmir Limaj dhe Ismet

Jashari kanë qenë të pranishëm atje dhe ju po tregoni se si dukej ceremonia e betimit të UÇK-së", ka thënë Kehoe.

Ndërsa kryetari i trupit gjyqësor, Charles Smith III, ka refuzuar kërkesën e ZPS-së që kjo video të pranohet si provë. "Pranohet (kërkesa e mbrojtjes). S'ka asnjë lidhje një video. Kjo video është e pavlerë", ka thënë Smith. Kujtojmë se më 3 prill ka filluar gjykimi i liderëve të UÇK-së, të cilët janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat e ZPS-së. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë duke u mbajtur në paraburgim nga muaji nëntor i vitit 2020. Mbrojtja e tyre vazhdimisht ka kërkuar që katërshja e UÇK-së të mbrohet në liri, por nuk është marrë parasysh nga Gjykata Speciale.

S'ka rrezik të ikjes: Si ia rrezoi trupi gjyqësor ZPS-së njërin nga arsyet për paraburgimin e krerëve të UÇK-së?

Drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, për gati tri vjet janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë nga Gjykata Speciale. Deri vonë një nga arsyet kryesore për vazhdimin e kësaj mase ka qenë edhe rreziku i ikjes. Megjithatë, në një vendim të fundit të trupit gjyqësor në Hagë është rrezuar ky arsyetim i Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Sipas Gjykatës Speciale, rreziku i arratisjes nuk qëndron më si arsyetim në këtë

kohë. Megjithatë, paraburgimi është vazhduar për shkak të rrezikut të ndikimit në prova, dëshmitarë dhe fuqisë së katërshes së UÇK-së në Kosovë. Rënia e arsytimit të arratisjes është bërë me dije në disa parashtime që janë publikuar deri më tash. "Paneli ka shqyrtuar argumentet e Prokurorisë në dritën e fazës aktuale të procedurës, dhe përderisa rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet kurrë plotësisht, ai ripohon se nuk gjen ndonjë faktor shtesë mjaftueshëm bindës për ta bindur panelin ta ndryshojë vendimin e mëparshëm në lidhje me rrezikun e fluturimit. Prandaj, paneli konstaton se vazhdimi i ndalimit të z. Veseli mund të mos justifikohet në këtë moment për shkak të rrezikut të ikjes në pajtim me nenin 41(6)(b)(i)", thuhet në këtë vendim.

Trupi gjyqësor e ka rrezuar edhe një pikë të ZPS-së, ku kjo e fundit e përmend dënimin e Salih Mustafës si argument për vazhdimin e paraburgimit. "Në lidhje me argumentin e Prokurorisë së aktgjykimit në rastin prokurori kundër Salih Mustafa do ta rriste perceptimin e z. Veseli për mundësinë e një dënimi më të gjatë për veten e tij, Paneli e konsideron këtë si spekulative. ZPS-ja nuk ka demonstruar se ky faktor tejkalon faktorët e tjerë që paneli i ka marrë parasysh në vendimet e tij të mëparshme. Në çdo rast, z. Veseli prezumohet të jetë i pafajshëm", është thënë në këtë vendim.

Këto vendime kanë vlejtur edhe për të akuzuarit e tjerë si Thaçi, Krasniqi dhe Selimi, jo vetëm për Kadri Veselin. Megjithatë, Prokuroria e Hagës edhe në kërkesën e fundit për caktim të paraburgimit, sërish e ka përmendur rrezikun e ikjes. Pra, ka insistuar në këtë argument edhe pse i është rrezuar dy herë nga trupi gjyqësor.

Shqipëri, projekte në fushën e turizmit dhe harmonizim i tij

TIRANË, 14 GUSHT - Fluksi i turistëve, që po vizitojnë Shqipërinë në këtë sezon veror, po njihet nga dita në ditë duke tejkaluar edhe pritshmëritë e këtij sektori. Vitet e fundit ka pasur investime të rëndësishme, kryesisht nga sektori privat si sa i përket turizmit bregdetar, ashtu edhe atij malor. Kjo ka nxitur institucionet qendrore, bashkitë, por edhe organizatat joqeveritare të përfshihen në një numër të madh projektesh me synim promovimin e turizmit. Vau Dejës është një nga bashkitë e vogla në Shqipëri, e cila, përmes fondeve të Bashkimit Evropian, po zbaton projektin "Vau Dejës një destinacion turistik".

Përgjegjësjë e turizmit në këtë bashki, Çuka Babani, thotë se, përveç Lumit të Shalës, kjo zonë ka potenciale të shumta në fushën e turizmit, të cilat vitet e fundit janë zbuluar kryesisht nga vizitorët e huaj përmes rrjeteve sociale.

Me këtë projekt ne kemi arritur ta sigurojmë sinjalistikën turistike, të munguar në Bashkinë Vau Dejës. Janë vendosur 35 tabela, të cilat sinjalizojnë pikat turistike të Bashkisë Vau Dejës, por edhe

përshkrimet përkatëse të këtyre zonave që kanë një vlerë turistike dhe kulturore, për të cilat turistët kanë se çfarë të shikojnë në bashkinë tonë.

Bashkimi Evropian po mbështet me fonde një numër projektesh të rëndësishme në fushën e turizmit, një prej të cilëve ishte ngritja e qendrës së informimit për turistët në plazhin e Shëngjinit, plazh ky që prej vitesh frekuentohet kryesisht nga pushuesit nga Kosova.

Për Bashkimin Evropian është përparësi mbështetja për Shqipërinë. Projekti ynë në fushën e turizmit po mbështet bashkitë të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e vendit në rrugën e integritimit evropian. Projekti ka mbështetur me grante 19 bashki të vendit, thotë menaxherja programit për qeverisjen rajonale dhe lokale në delegacionin e BE-së në Shqipëri, Marie Augouy.

Fluksi në rritje i turistëve, përfshirja e një numri të madh institucionesh dhe organizatash në nxitjen dhe promovimin e turizmit, sipas këshilltares në Ministrinë e Kulturës, Arlinda Kondi, është diçka pozitive, por është e rëndësishme që të mos ketë mbivendosje projektesh që



harxhojnë energji dhe fonde të panevojshme.

Realisht ka shumë iniciativa dhe shumë projekte që janë duke u zbatuar në rang bashkie, në rang institucionesh publike dhe është shumë e rëndësishme që ne të kemi një pasqyrë dhe kuadër tërësor të të gjithë ndërhyrjeve që janë bërë vitet e fundit kryesisht dhe të kuptojmë çfarë

nuk duhet të mbivendoset dhe çfarë janë hapësirat ku mund të ndërhyjmë.

Vetë Ministria e Kulturës, sipas Kondit, është partnere në 11 projekte në fushën e turizmit dhe, në një tjetër, është udhëheqëse e projektit. Ajo thotë se është e rëndësishme të vendoset një balancë mes asaj që u ofrohet turistëve dhe

nevojës për t'i ruajtur nga dëmtimi vlerat e trashëgimisë kulturore.

Sipas të dhënave zyrtare, në gjashtëmuorin e parë të këtij viti Shqipëria ka pritur 33 % më shumë vizitorë të huaj krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, por pritshmëritë janë edhe më të larta për muajt në vazhdim.

Falja e tatimit në pronë shpëton qytetarët, dëmton komunat

PRISHTINË, 14 GUSHT - Qytetarëve të Kosovës u janë falur 100 euro të tatimit në pronë për vitin 2023, mirëpo në vitet e tjera ata do t'i paguajnë faturat me ngritje. Kështu thonë për "Radio Kosovën" nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. E përfaqësues të shoqërisë civile thonë se falja e këtyre mjeteve do të ndikojë në investime kapitale. Miratimi i plotësim-ndryshimit të Ligjit për Tatimin në Pronë po vlerësohet se do t'i dëmtojë komunat me miliona euro. Sipas Asociacionit të Komunave të Kosovës, komunat presin të kompensohen për humbjet që do t'i pësojnë me faljen e 100 eurove në bazë të këtij



projektligji.

Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, thotë se komunat në këtë rast do të pësojnë dëme financiare, sepse mjetet nuk do t'i kompensojë niveli qendror. Ai

shpjegon për "Radio Kosovën" se kjo falje prej 100 eurosh për qytetarët është vetëm për këtë vit. "Qytetarët duhet ta dinë se vitin e ardhshëm do ta paguajnë faturën e tatimit në pronë me ngritjen që e ka bërë Ministria e

Financave gjatë vitit 2023. Kjo falje do të vlejë vetëm për vitin 2023, sepse viteve të ardhshme do të paguhet fatura e tatimit në pronë me atë rritje që është bërë nga Ministria e Financave", tha ai. Sazan Ibrahim tha se është e pakuptimtë që niveli qendror të marrë vendime për nivelin lokal. "Ne jemi çuditur me urgjencën që Kuvendi i Kosovës e ka ndërmarrë për sa i përket miratimit të këtij ligji, sepse kemi pritur që së pari të konsultohen kryetarët e komunave dhe komunat, sepse tatimi në pronë dhe të hyrat nga tatimi në pronë janë të hyra të komunave e nuk janë të nivelit qendror", ka deklaruar ai.

E hulumtuesi i Iniciativës për Progres (INPO), Valmir Ilazi, konsideron se falja e 100 eurove të tatimit për qytetarët është e mirëpritur. Mirëpo ky vendim, siç thotë ai, do të ndikojë në të hyrat e komunave. "Do të ndikojë në uljen e të hyrave të komunave duke qenë se burimi kryesor i komunave është tatimi dhe do të ndikojë te projektet dhe investimet kapitale që komunat tashmë i kanë në plan të prokurimit", ka thënë Ilazi. Ndërkaq në Kuvendin e Kosovës ka kaluar ligji i cili shtrenjton tatimin në pronë. Tatimi në varësi të vlerës së pronës diku është rritur 100 për qind, diku ka mbetur i njëjtë.

Rubla ruse bie afër nivelit më të ulët të 17 muajve

MOSKË, 14 GUSHT - Rubla rrëshqiti nën vlerën 100 kundrejt dollarit amerikan, duke iu afruar nivelit më të ulët në 17 muaj. Valuta ruse ka humbur rreth 30 për qind ndaj monedhës së gjelbër që nga fillimi i vitit. Banka e Rusisë ka fajësuar tkurrjen e bilancit tregtar të vendit, pasi suficit i logarisë rrjedhëse të Rusisë ra 85 për qind nga viti në vit nga

janari në korrik. Banka Qendrore ruse ka ndaluar blerjet e valutës së huaj për pjesën tjetër të vitit në një përpjekje për ta mbështetur monedhën, e cila po ushqen frikën e rritjes së inflacionit, ndërsa Rusia përpiqet ta transformojë rrënjësisht ekonominë e saj përballë izolimit në rritje dhe sanksioneve ndëshkuese perëndimore.

William Jackson, kryeekonomist i tregjeve në zhvillim në Capital Economics, vuri në dukje se ngadalësimi i kufizuar në ekonomi ka të ngjarë t'i nxisë më tej presionet e inflacionit dhe të rezultojë në shtrëngim të politikës monetare, duke dobësuar potencialisht rritjen gjatë pjesës së mbetur të vitit dhe më 2024.



Ka ardhur koha që Evropa të mbrojë veten

Nga Rajan MENON
"New York Times"

Që nga fillimi i pushtimit të Ukrainës nga presidenti rus Vladimir Putin, narrativa e zyrtarëve amerikanë dhe evropianë ka qenë se Rusia, një shtet grabitqar, është e prirur t'i dominojë fqinjët e saj, duke përbërë një kërcënim të madh ushtarak për të gjithë Evropën.

Vendimet e Finlandës dhe Suedisë për t'iu bashkuar NATO-s, e përforcojnë këtë qasje dhe duket se aleanca e pranoi atë edhe gjatë samitit të saj këtë javë në Vilnius të Lituaniës. Në Perëndimi i mbizotëroi konsensusit se Putin e kishte transformuar ushtrinë ruse në një makineri të frikshme luftarake, një vlerësim i ilustruar nga një titull i revistës "The Economist" në fund të vitit 2020 "Shkëlqimi verbues i Forcave Ushtarake Ruse pas një dekade reformash".

Në fakt, performanca e ushtrisë ruse në Ukrainë ka qenë gjithçka tjetër veçse jo e shkëlqyer. Pavarësisht shpenzimit të 650 miliardë dollarëve për modernizimin e ushtrisë që nisi në vitin 2010, ajo ka pësuar humbje shumë të mëdha në pajisje, dhjetëra mijëra viktima dhe dështime të vazhdueshme logjistike.

E megjithatë Evropa po vepron sikur nuk e ka aftësinë për të shmangur një sulm rus, duke vazhduar që t'i drejtohet Shteteve të Bashkuara për mbështetje ushtarake. Në samitin e Vilniusit, aleatët e Uashingtonit u zotuan, siç bënë gati një dekadë më parë, të shtojnë shpenzimet e tyre ushtarake.

Por mes tyre ka dallime nëse kjo shifër duhet të shërbejë si tavan apo dysheme. Është e vërtetë që rekordi i vendeve evropiane në përmbushjen e udhëzimeve të NATO-s të vitit 2014 – 2 për qind e PBB-së shpenzime vjetore ushtarake dhe 20 për qind e buxhetit ushtarak për pajisje të reja, kërkime dhe zhvillim – ka qenë i dobët.

Gjatë viteve 2016-2022, vetëm 4 deri në 10 vende të NATO-s, përfshirë Shtetet e Bashkuara, e arritën objektivin e 2 përqindëshit. Ky dështim nuk e ka burimin tek mungesa e burimeve financiare por tek



vullneti politik. Një mungesë motivimi e rrënjosur tek varësia e saj prej dekadash nga Amerika.

Nga ana e tij Uashingtoni, e ka kultivuar atë mbështetje për të rritur të ardhurat e industrisë së tij të armëve dhe po aq e rëndësishme, për të përforcuar varësinë evropiane nga fuqia amerikane. Pretendimi se vendet evropiane të pasura dhe të përparuara teknologjikisht nuk mund të bashkojnë dot forcat për të pasur një fuqi ushtarake të mjaftueshme për të penguar ose mposhtur Rusinë, e dëmton shumë besueshmërinë.

Anëtarja e 31-të dhe më e re e NATO-s, Finlanda, dhe anëtarja e ardhshme Suedia, kanë ushtri të fuqishme, dhe ushtria e Ukrainës – që është më e mirë-pajisur, më e stërvitur dhe e kalitur në beteja sesa ishte para vitit 2022 – do t'i vinte me siguri në mbrojtje të Evropës në rastin e një sulmi rus.

Fuqia ushtarake amerikane do të jetë gjithashtu një shtesë e besueshme. Tek e fundit, realiteti është se evropianët kanë jo vetëm mjetet për të mbrojtur kontinentin e tyre, por edhe një nxitje shumë më të madhe për ta bërë këtë sesa Shtetet e Bashkuara.

Apelet për vetë-mjaftueshmërinë evropiane nuk janë të barabarta me mbrojtjen e shfuqizimit të NATO-s. Ka ardhur koha që Evropa të merret seriozisht me mbrojtjen e saj. Nuk ka dyshim se 16 muaj pas luftës, Rusia i ka shkaktuar dëme të mëdha Ukrainës.

Sipas Shkollës Ekonomike të

Kievit, vetëm dëmet në infrastrukturë i kalojnë 138 miliardë dollarë (që nga janari i këtij viti), Sa i përket numrit të viktimave, sipas Kombeve të Bashkuara deri në mesin e qershorit, (ishin vlarë 9.083 civilë dhe plagosur 15.779).

Duke vizituar 3 herë Ukrainën e kohës së luftës, përfshirë vendet pranë frontit lindor dhe jugor të luftës, i kam parë me sytë e mirë shkatërrimet e mëdha. Fotografitë dhe reportazhet e medias nuk mund ta rrokin plotësisht panoramën. Por Rusia nuk ka qenë në gjendje që ta transformojë avantazhin e saj të madh në trupa dhe armë, në asgjë që t'i ngjajë fitores.

S'ka dyshim se vështirësitë e saj janë rritur për shkak të ndihmës ushtarake amerikane, prej më shumë se 46 miliardë dollarësh që ka marrë Ukraina, së bashku me mbështetjen shtesë nga NATO dhe vende të tjera. Por ushtria ukrainase e pengoi pushtimin e Kievit edhe para se armatimi amerikan të niste të mbërrinte në sasi të mëdha.

Armët perëndimore janë pjesë e arsyes së betejave të Rusisë, por po ashtu edhe morali i fortë dhe përgatitja në total me e mirë e ushtrisë ukrainase. Pjesa tjetër e Evropës, burimet e së cilës i tejkalojnë shumë ato të Ukrainës, ndodhet në një pozicion akoma më të fortë.

Krahasoni Evropën dhe Rusinë në çdo parametër që përdoret zakonisht për matjen e fuqisë, dhe Evropa rezulton të jetë jashtëzakonisht superiore. Shihni pak prodhimin e brendshëm bruto. Vitin e kaluar ai i

Bashkimit Evropian ishte 16.6 trilionë dollarë, ndërsa ai i Rusisë 2.2 trilionë dollarë.

Kjo do të thotë se edhe pa Britaninë, Bashkimi Evropian ka një ekonomi më shumë se 7 herë më të madhe se ajo e Rusisë. Po teknologjia, një element tjetër jetik në luftën bashkëkohore? Këtu gjërat bëhen më të ndërlikuara, pasi asnjë statistikë e vetme nuk vlen për të bërë një krahasim të saktë.

Mendoni pak për elektronikën e nivelit të lartë, makinat luksoze apo çdo gjë që përfshin Inteligjencën Artificiale që keni përdorur apo parë kohët e fundit. Unë do të imagjinoja se shumë pak, nëse ka, janë me origjinë ruse. Këtë e vërtetojnë të dhënat e përziera të disa pajisjeve ruse të përdorura në fushat e betejës së Ukrainës.

Analizat e pajisjeve të shkatërruara apo të kapura nga ukrainasit zbuluan se të gjitha ato mbështeteshin në pjesë përbërëse të prodhuar në Shtetet e Bashkuara, Evropë, Japoni ose Korenë e Jugut. Si është Evropa në raport me Rusinë kur flitet për numrin e armatimeve kryesore, si tanket, avionët luftarakë, luftanijet dhe artilerinë?

Rusia kryeson në disa kategori kryesore, por kryesisht jo në avantazhin numerik që do të kërkonte një forcë sulmuese – zakonisht 3 me 1, një rregull që është vërtetuar në shumë raste. Për më tepër Evropa zotëron mjetet ekonomike dhe teknologjike për të rritur prodhimin e armatimit.

Britania dhe vendet e Evropës kontinentale kanë industri

armësh të klasit botëror, përfshirë gjigantë të tillë si BAE Systems në Britani, Thales dhe Safran në Francë, Leonardo në Itali dhe Rheinmetall në Gjermani. Realizimi i potencialit për një vetë-mjaftueshmëri më të madhe, do të kërkojë investime dhe një koordinim të konsiderueshëm në prodhimin evropian të armëve, për të shmangur përsëritjet dhe arritur një ndarje të punës që e maksimizon avantazhin krahasues.

Por këto janë detyra pothuajse të pamundura. Evropianët kanë qenë shumë të suksesshëm në veprimin kolektiv për të kapërcyer barrierat tradicionale të sovranitetit kombëtar. Për shembull përmendim arritje të tilla historike si miratimi i një monedhe të përbashkët nga 27 vendet e BE-së, krijimin e Bankës Qendrore Evropiane dhe Marrëveshjen e Shengenit, e cila hoqi kontrollin në kufijtë e brendshëm.

Ushtria ruse nuk është tigër letre. Por leksioni që duhet mësuar nga lufta në Ukrainë, është se evropianët janë plotësisht të aftë të marrin përsipër përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e tyre. Kjo është diçka që ata duhet ta bëjnë me interesin e tyre të plotë.

Ju pëlqen apo jo, fokusi i ushtrisë amerikane do të përqendrohet gjithnjë e më shumë në Azi-Paqësorin. Aleatët evropianë të Amerikës, kanë rënë dakord tashmë të luajnë një rol më të madh në sigurinë e Azi-Paqësorit për ta ndihmuar Uashingtonin të kundërshtojë fuqinë ushtarake në rritje të Pekinit. Në vend të kësaj, ata duhet të fokusohen në mbrojtjen e kontinentit të tyre. Evropa duhet të heqë dorë nga diskutimet e vjetra me Shtetet e Bashkuara për një ndarje më të mirë të barrës dhe të merret seriozisht me zhvendosjen e barrës mbi supet e veta.

Shënim: Rajan Menon, drejtor i programit të strategjive të mbrojtjes në Institutin Saltzman të Studimeve të Luftës dhe Paqes të Universitetit të Kolumbias, Nju Jork.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova U19 e vajzave do t'i zhvillojë dy miqësore me Malin e Zi

PRISHTINË, 14 GUSHT - Përfaqësuesja e Kosovës U19 e vajzave në futboll është nisur për në Rozhajë, ku do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore me Kombëtaren e Malit të Zi të së njëjtës

grupmoshë. Pjesë e ekspeditës është edhe përzgjedhësja e Përfaqësues A, Anneli Andersen, e cila, përveçse do të ndihmojë me këshillat e saj, do ta shohë nga afër potencialin e

lojtareve të reja, të cilat në të ardhmen do ta bartin barrën në Përfaqësuesen A. Ndeshja e parë do të zhvillohet sot (më 15 gusht) në orën 17:30, ndërsa ndeshja e dytë të enjten (më

17 gusht) në orën 10:00. Paraprakisht "dardanet" U19 nën drejtimin e Albina Rrahmanit kanë mbajtur përgatitje treditore në Kampin Nacional në Hajvali..



Arlind Veliu, 'Ylli i javës' së parë në Superligë

MALISHEVË, 14 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, edhe këtë edicion do të japin çmimi "Ylli i javës". Në xhiron e parë ky çmim i ka takuar mbrojtësit të KF Malisheva, Arlind Veliu. Ky i fundit në ndeshjen kundër Dukagjinit ishte mbrojtës i pakaluar dhe shumë i dobishëm edhe në fazën ofensive, duke shënuar golin e vetëm në ndeshjen që ia mundësoi FC

Malisheva t'i gëzohet fitores dhe t'i arkëtojë tri pikët e para në Albi Mall Superliga - edicioni 2023/24. Pasi mori këtë çmim, Arlind Veliu u shpreh i lumtur që skuadra e tij e nisi mbarë edicionin e ri garues në elitën e futbollit në Kosovë. "Ndihe shumë mirë dhe i lumtur për këtë vlerësim dhe dua t'i falënderoj bashkëlojtarët e skuadrës dhe shtabin teknik pa të cilët sigurisht se nuk do të

mund ta fitoja këtë çmim. Malisheva ka nisur me fitore këtë kampionat dhe shpresoj të na shkojë mbarë i tërë kampionati. Skuadra jonë ka pasur shumë ndryshime nga merkatoja e fundit dhe na duhet ende kohë të komponohemi dhe të arrijmë të luajmë sipas filozofisë së trajnerit. Por, jemi shumë të motivuar dhe atmosfera në ekip është shumë e mirë", ka thënë Veliu për faqen zyrtare të FFK-së.



Abrashi, 10 vjet shqiponjë



TIRANË, 14 GUSHT - Data 14 gusht është e veçantë për mesfushorin Amir Abrashi, i cili është një futbollist me trup të shkurtër, por me zemër të madhe. Abrashi në këtë datë bëri debutimin për Kombëtaren e Shqipërisë, më pas u shndërrua në një prej futbollistëve më të rëndësishëm, duke qenë edhe pjesë e

Kampionatit Evropian në vitin 2016. Federata Shqiptare e Futbollit e ka vlerësuar lart rolin e mesfushorit në radhët e ekipit kuqezi ku regjistroi 50 ndeshje. "10 vjet shqiponjë. Amir Abrashi nuk e harron lehtë 14 gushtin e vitit 2013, kur Shqipëria mposhti 2-0 Armeninë në miqësore. Ishte ndeshja e tij e parë me fanellën e

Shqipërisë dhe deri më tani numëron 50 të tilla, mes tyre edhe duelet historike në 'Euro 2016'. Fjalëpakë, Amir Abrashi ka dhënë kontribut me kombëtaren duke qenë një nga lojtarët më të rëndësishëm dhe protagonist absolut në sukseset e arritura", thuhet në postimin e FShF-së.

Rexha rikthehet te KB Vëllaznimi

GJAKOVË, 14 GUSHT - KB Vëllaznimi ka njoftuar se ka nënshkruar me Bardh Rexhën. Lajmi është dhënë nga klubi kuqezi në rrjetet sociale. "Rexha, i cili ishte pjesë e ekipit të Vëllaznimit në rikthimin tonë në Superligë, tash rikthehet në klubin tonë, të cilin ai e cilëson si 'shtëpinë' e dytë. 22-vjeçari dallohet për lojën e fuqishme në mbrojtje dhe shumanshmërinë taktike në sulm. Në edicionin e

kaluar ishte ndër lojtarët kryesor të KB Rahovecit", thuhet në njoftimin e Vëllaznimit. Rexha luan në pozitat 3 dhe 4, por shpeshherë ka luajtur edhe në pozitat e tjera, duke treguar shpirtin luftarak dhe shumanshmërinë. Në edicionin e kaluar ai u paraqit në 24 ndeshje për KB Rahovecin, ku regjistroi mesatare prej 7.5 pikëve, 5.4 kërcimeve dhe 1.6 asistimeve për ndeshje.



Obërtinca në programin FIBA Europe Coaching Certificate

SHKUP, 14 GUSHT - Driton Obërtinca ka marrë pjesë në programin FECC (FIBA Europe Coaching Certificate) që u zhvillua në Shkup të Maqedonisë Veriore. Ky program është për një periudhë trevjeçare, ndërsa

Obërtinca, i cili është përzgjedhur nga FBK-ja, ndoqi nga afër klinikën në Shkup, ku u zhvillua edhe Kampionati Evropian, Divizioni A, për meshkuj U16. Qëllimi i organizimit të klinikave në përpunje me Kampionatin

Evropian për meshkuj U16, U18 dhe U20 është për ta monitoruar zhvillimin e lojtarëve të rinj nga mosha 15 deri në 20 vjeç gjatë një periudhe prej dy deri në tre vjet në garat kryesore. Gjatë tri viteve trajnerët do të ndjekin

programe të ndryshme zhvillimore për gjeneratat e reja. Në këtë program janë certifikuar Valentin Spaqi, Gyltekin Selimi, Dritëro Sefaja, Edon Godeni, Petrit Zeqiri dhe Ilir Selmani, që ishin nominuar nga FBK-ja.



Kane thyen të gjitha rekordet me shitjet e fanellave në Gjermani

MÜNCHEN, 14 GUSHT - Bayern Munchen ka arritur të nënshkruajë me Harry Kanen pas negociatave të stërzgjatura me Tottenham Hotspursin. "Bavarezët" u pajtuan të paguajnë 100 milionë euro te "Spursi" për transferimin e tij, plus 10 milionë euro të tjera në formë bonusesh. 30-vjeçari ka

nënshkruar një kontratë katërvjeçare me Bayernin nga e cila do të fitojë 25 milionë euro bruto në sezon, apo rreth 15 neto. Kapiteni i Anglisë është bërë blerja më e shtrenjtë jo vetëm në historinë e Bayernit, por në të gjithë futbollin gjerman. E përditshmja gjermane "Sport

Bild" ka raportuar se është thyer një rekord edhe sa i përket shitjes së fanellave të Harry Kanes nga tifozët "bavarezë". Në fakt, Bayerni nuk ka fituar kurrë kaq shumë në një ditë me fanella me emrin e një lojtari. Para fundit të ditës së diel, Bayerni ka shitur më shumë se 10 mijë

fanella me emrin Kane dhe numrin nëntë. Fanellat origjinale të Kanes kushtojnë nga 75 euro (për fëmijë) deri në 138 euro. Nëse e vendosim çmimin mesatar 100 euro, atëherë duket qartë se vetëm të dielën Bayerni ka shitur fanellat e Kanes për më shumë se një milion euro.



Neymari bëhet 'sheik', 160 milionë euro për dy vjet ndryshuan historinë

MÜNCHEN, 14 GUSHT - Bayern Munchen ka arritur të nënshkruajë me Harry Kanen pas negociatave të stërzgjatura me Tottenham Hotspursin. "Bavarezët" u pajtuan të paguajnë 100 milionë euro te "Spursi" për transferimin e tij, plus 10 milionë euro të tjera në formë bonusesh. 30-vjeçari ka nënshkruar një kontratë katërvjeçare me Bayernin nga e cila do të fitojë 25 milionë euro bruto në sezon, apo rreth 15 neto. Kapiteni i Anglisë është bërë blerja më e shtrenjtë jo vetëm në historinë e Bayernit, por në të gjithë futbollin gjerman. E përditshmja gjermane "Sport Bild" ka raportuar se është thyer një rekord edhe sa i përket shitjes së fanellave të Harry Kanes nga tifozët "bavarezë". Në fakt



,Bayerni nuk ka fituar kurrë kaq shumë në një ditë me fanella me emrin e një lojtari. Para fundit të ditës së diel, Bayerni ka shitur më shumë se 10 mijë fanella me emrin Kane dhe numrin nëntë. Fanellat origjinale të Kanes

kushtojnë nga 75 euro (për fëmijë) deri në 138 euro. Nëse e vendosim çmimin mesatar 100 euro, atëherë duket qartë se vetëm të dielën Bayerni ka shitur fanellat e Kanes për më shumë se një milion euro.

Kepa arrin marrëveshje me Realin, paraqitet sot

MADRID, 14 GUSHT - Kepa Arrizabalaga edhe zyrtarisht është bërë pjesë e Real Madridit. Portieri spanjoll i është bashkuar klubit të Realit në formë huazimi nga Chelsea. Sa ishte pjesë e klubit anglez, Kepa e ka fituar një Ligë të Kampionëve, Kupën e Botës për klube, një Superkupë Evropiane dhe një Ligë të Evropës. "Real Madridi dhe Chelsea kanë rënë dakord për huazimin e portierit Kepa Arrizabalaga, i cili është i lidhur me klubin këtë sezon, deri më 30 qershor 2024. Në pesë sezonet e tij në Chelsea ai ka fituar një Ligë të Kampionëve, një Kupë të Botës për klube, një Superkupë Evropiane dhe një Ligë të Evropës. Këtë vit ai ka marrë çmimin për pritjen më të mirë në Ligën Premier për sezonin 2022-2023. Kepa është ndërkombëtar me skuadrën spanjolle, me të cilën është shpallur kampion i



Ligës së Kombeve të vitit 2023. Me Spanjën ka fituar edhe Kampionatin Evropian U19 në vitin 2012", thuhet në njoftimin e

Real Madridit. Të martën në orën 13:00 në Madrid do të zhvillohet ceremonia e prezantimit të Kepës si lojtar i ri i Real Madridit.

SHKURT

Milani rikthen interesimin për Brojën

AC Milan është në kërkim të një sulmuesi tjetër për sezonin 2023/24 ka njoftuar mediumi italian "La Gazzetta dello Sport". Gjithnjë sipas këtij mediumi, Milani është i interesuar për sulmuesin Armando Broja. Sulmuesi kuqezi nuk është në planet e Chelseat dhe skuadra e Milanit mund ta marrë edhe në formë huazimi. Milani e ka në listë edhe sulmuesin Ekitike, i cili nuk bën pjesë në planet e Paris Saint-Germainit.

Caicedo, lojtar i ri i Chelseat

Chelsea ka arritur përfundimisht që të transferojë Moises Caicedo nga Brighton. Interesim për 21-vjeçarin kishte shprehur edhe Liverpooli, por Chelsea doli më e suksesshme dhe siguroi shërbimet e mesfushorit në fjalë për shumën prej 115 milionë paundësh. Caicedo do të nënshkruajë një kontratë deri në qershor të vitit 2031, me një opsion rinovimi automatik deri më 2032.

Conte ose Spalletti e zëvendësojnë Mançinin

Kombëtarja e Italisë ka mbetur pa trajner pas largimit të Roberto Mançinit. "Italian Sky" raporton se Antonio Conte dhe Luciano Spalletti janë kandidatët kryesorë për të qenë pasues të Mançinit. Conte u largua nga Tottenhami në pranverë, ndërkohë Spalletti u nda me Napolin pas sezonit të fundit kampion. Conte ka qenë edhe në të kaluarën trajner i Italisë. Në 24 ndeshje gjatë kësaj periudhe, skuadra mori 14 fitore, 6 barazime dhe 4 humbje.

Tottenhami e dëshiron Lukakun

E ardhmja e Romelu Lukakut është ende e pasigurt. Bisedimet në mes të Chelseas dhe Juventusit për shkëmbimin me Vlahoviçin janë ndërprerë, dhe duke qenë se belgu ka refuzuar gjithmonë ofertat arabe, tregon se ai dëshiron të qëndrojë në Evropë. Tottenham Hotspuri humbi Harry Kanen me sulmuesin anglez i cili tashmë është sulmuesi më i ri i klubit gjerman të Bayern Munichut. Tashmë skuadra londineze është në kërkim të një sulmuesi pykë dhe emri i lakuar për të zëvendësuar Kanen është pikërisht Lukaku. Kostoja e belgut është relativisht e ulët, pra Chelsea do të kërkonte të paktën 45-50 milionë euro për kartonin e tij. Tottenhami është seriozisht në garë tashmë për t'i fituar shërbimet e ish-sulmuesit të Interit.

Barça e nisi me barazim, Xavi kritikon gjyqtarët


Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, nuk e ka fshehur zhgënjimin e tij pas barazimit 0-0 kundër Getafes. Edhe vetë ai ka qenë protagonist me kartonin e kuq të marrë në pjesën e dytë.

Numri një i stolit katalanas ka shpjeguar episodin, duke e quajtur të pakuptimtë vendimin e gjyqtarit për ta përjashtuar. "I thashë se po lejonin shumë faulle. Për këtë më përjashtoi. Një ditë tjetër patëm një

takim me gjyqtarët dhe ndryshimi i parë në rregull që na thanë ishte se do ta kuptonin por, në fakt, duket se nuk e kanë kuptuar ata. Ajo që ndodhi në fushë ka rëndësi. Ne u përpoqëm gjithsesi, por nuk

ia dolëm. Mendoj se e meritoni të fitoni, por nuk mjaftoi", ka deklaruar Xavi, i cili e komentoi edhe kartonin e kuq të Rafinhës. "Çështja 'Rafinha' është një mori gjërash. Gjyqtarët lejuan çdo

goditje ndaj tij dhe në të parin reagim të tij e nxorën me të kuq. Është për të ardhur keq. Dua ta nisim me fitore, por edhe vitin e kaluar e nisëm njësoj dhe përfundam mirë".



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Qendra Radiologjike Diagnostike Plus" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nrb: 811579822.

- Mery's V& F- SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810816621.

- Xheneta Ujkani shpall të pavlefshme diplomë e masterit drejtimi Ekonomiks në UP.

- Afrim Vehapi B.I. DPZ "ONIKS-1" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, për import-export, me numër unik të biznesit: 810345654.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

